



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendos: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 24 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi kërkesën e Prokurorit për zgjatjen e afatit për dhënien e njoftimit sipas rregullës 102(3)

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtësit të viktimave

Sajmën Loz

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtësit të Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(13) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 102(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) lëshon këtë urdhër .

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi, *ndër të tjera*, që Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) të jepte një njoftim të hollësishëm të provave sipas rregullës 102(3) të Rregullores deri të premtën, 30 prill 2021.²
2. Më 24 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e zgjati afatin e ZPS-së për t’i dhënë Mbrojtjes njoftim të hollësishëm për provat sipas rregullës 102(3) të Rregullores deri të premtën, 25 qershor 2021.³
3. Më 18 qershor 2021, ZPS-ja dorëzoi një kërkesë për zgjatjen e afatit në lidhje me njoftimin sipas rregullës 102(3) (“Kërkesa”).⁴ Të njëjtën ditë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i urdhëroi palët të jepnin përgjigje dhe kundërpërgjigje të shpejta.⁵
4. Më 22 qershor 2021, Jakup Krasniqi (“z. Krasniqi”) parashtroi përgjigjen e tij.⁶

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje të lidhura me të* (“Vendimi kornizë për nxjerrjen”), 23 nëntor 2020, publik, para. 99(f).

³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 24 mars 2021, publik, f. 390, rreshti 17 deri në f. 391, rreshti 10.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00356, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për zgjatjen e afatit për dhënien e njoftimit sipas rregullës 102(3)*, 18 qershor 2021, publik.

⁵ KSC-BC-2020-06, F00359, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për përgjigje dhe kundërpërgjigje të shpejta*, 18 qershor 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00364, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Përgjigje e Mbrojtjes së Krasniqit ndaj kërkesës së Prokurorisë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e njoftimit sipas rregullës 102(3)* (“Përgjigja e Krasniqit”), 22 qershor 2021, publike.

5. Më 23 qershor 2021, Kadri Veseli ("z. Veseli") dhe Rexhep Selimi ("z. Selimi") parashtruan përgjigjet e tyre përkatëse.⁷ ZPS-ja nuk parashtroi kundërpërgjigje.

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja kërkon që afati për dorëzimin e njoftimit sipas rregullës 102(3) të zgjatet deri më 30 korrik 2021.⁸ ZPS-ja parashtron se arsyet e vlefshme për zgjatjen e afatit tregohen nga fakti që nxjerrja e materialit sipas rregullës 102(3), i cili është plotësues për nga natyra,⁹ duhet të ndodhë në një fazë të procedurave kur nxjerrja e materialit në pajtim me rregullat e tjera të ketë përparuar mjaftueshëm.¹⁰ ZPS-ja tregon se pas kryerjes së një "bilanci" të procesit aktual të nxjerrjes së materialeve, është e qartë se njoftimi sipas rregullës 102(3) duhet domosdoshmërisht të bëhet pas përfundimit të nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(b), për të shmangur përsëritjet dhe për të siguruar që të mos devijohen kapacitetet nga puna për nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(b).¹¹ ZPS-ja nuk ka kundërshtim që, nëse ndryshohet afati për të, të ndryshojë rrjedhimisht edhe afati i 20 gushtit 2021 që i ishte caktuar Mbrojtjes për të kërkuar materialet sipas rregullës 102(3).¹²

7. Z. Krasniqi përgjigjet se ai nuk e kundërshton zgjatjen e kërkuar dhe do të kërkojë ndryshim të barasvlershëm të afatit të Mbrojtjes për të kërkuar materialet sipas rregullës 102(3).¹³

⁷ KSC-BC-2020-06, F00367, Mbrojtja e z. Veseli, *Përgjigje e Mbrojtjes së Veselit ndaj kërkesës së ZPS-së KSC-BC-2020-06/F00356 (Zgjatja e afatit për dorëzimin e njoftimit sipas rregullës 102(3))* ("Përgjigjja e Veselit"), 23 qershor 2021, publike; F00368, Mbrojtja për z. Selimi, *Përgjigje e Mbrojtjes së Selimit ndaj "Kërkesës së Prokurorisë për zgjatjen e afatit për dorëzimin e njoftimit sipas rregullës 102(3))* ("Përgjigjja e Selimit"), 23 qershor 2021, publike.

⁸ Kërkesa, para. 1.

⁹ Vendimi kornizë mbi nxjerrjen e provave, para. 26.

¹⁰ Kërkesa, para. 1-2.

¹¹ Kërkesa, para. 3-6.

¹² Kërkesa, para. 7.

¹³ Përgjigjja e Krasniqit, para. 3.

8. Z. Veseli e kundërshton kërkesën, sepse ajo nuk u bë brenda afatit, nuk është përligjur me arsye të vlefshme dhe është në dëm të tij.¹⁴ Z. Veseli vë në pah faktin se kërkesa u bë vetëm një javë përpara afatit të përcaktuar.¹⁵ Z. Veseli pretendon se ZPS-ja i kishte të qarta detyrimet e shumëfishta për nxjerrje të materialeve dhe kapacitetet e shumta që duhen për të përmbushur këto detyrime shumë kohë përpara afatit që i ishte caktuar.¹⁶ Z. Veseli pohon se, nëse kërkesa miratohet, Mbrojtja do të duhet të rivlerësojë kalendarin e saj për hetimet.¹⁷ Z. Veseli parashtron se çdo vonesë tjetër e shkaktuar nga ZPS-ja ndërsa z. Veseli mbetet në paraburgim është e papranueshme.¹⁸ Z. Veseli i kërkon Gjykatësit të Procedurës Paraprake të hedhë poshtë kërkesën.¹⁹
9. Z. Selimi përgjigjet se ai nuk e kundërshton kërkesën për zgjatje të afatit për ZPS-në dhe kërkon zgjatjen e afatit të Mbrojtjes në lidhje me materialet sipas rregullës 102(3) deri më 24 shtator 2021.²⁰

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Në bazë të rregullës 9(5)(a) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.
11. Në bazë të rregullës 102(3) të Rregullores, bazuar në nenin 21(6) të Ligjit, Prokurori i Specializuar i jep njoftim të hollësishëm Mbrojtjes për çdo material dhe provë që ka në zotërim.
12. Në bazë të rregullës 97(2) të Rregullores, vendimet në lidhje me mocionet paraprake merren brenda njëzet e një (21) ditësh pas parashtrimit të fundit.

¹⁴ Përgjigja e Veselit, para. 2-9.

¹⁵ Përgjigja e Veselit, para. 3-4.

¹⁶ Përgjigja e Veselit, para. 5-7.

¹⁷ Përgjigja e Veselit, para. 8.

¹⁸ Përgjigja e Veselit, para. 9.

¹⁹ Përgjigja e Veselit, para. 10.

²⁰ Përgjigja e Selimit, para. 3-4.

IV. DISKUTIM

a. Njoftimi sipas rregullës 102(3)

13. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se përderisa ZPS-ja nuk e ka përfunduar nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(b),²¹ do të ishte më efikase që procesi i nxjerrjes të ndryshohej në mënyrë që ZPS-ja të japë njoftimin e saj sipas rregullës 102(3) pas përfundimit të nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(b), në mënyrë që të shmangen përsëritjet përmes përfshirjes së materialit sipas rregullës 102(1)(b) në njoftimin sipas rregullës 102(3). Ndonëse njoftimi lidhur me pamundësinë e ZPS-së për t'iu përmbajtur afatit të përcaktuar mund të ishte parashtruar më herët, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vlerëson se një vonesë e tillë u shkaktua nga përpjekjet vullnetmira për të përmbushur afatin e përcaktuar. Për më tepër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake thekson se është e rëndësishme që nxjerrja të bëhet në mënyrë të kujdesshme për të shmangur ndonjë problem që mund të dalë nga nxitimi për t'iu përmbajtur afatit.

14. Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk mendon se zgjatja e afatit të ZPS-së për dorëzimin e njoftimit sipas rregullës 102(3)²² i shkakton ndonjë dëm Mbrojtjes. Një zgjatje e ngjashme afati do t'i miratohet edhe Mbrojtjes, në mënyrë që të jepet kohë e mjaftueshme për rishikimin e njoftimit të ZPS-së sipas rregullës 102(3). Përveç kësaj, pjesa më e madhe e materialeve të nxjerra nga ZPS-ja në bazë të Rregullës 102(1)(a) dhe 102(1)(b) të Rregullores do të jetë bërë përpara dhënies së njoftimit nga ZPS-ja sipas rregullës 102(3), duke mos krijuar kështu asnjë pengesë për vazhdimin e hetimeve të Mbrojtjes. Së fundi, Mbrojtja është e lirë t'i kërkojë ZPS-

²¹ KSC-BC-2020-06, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për kategorizimin e provave sipas rregullës 109(c) dhe çështje të lidhura me të*, 12 mars 2021, publik, para. 22.

²² Sa i takon ndikimit mbi çështjet e lidhura me paraburgimin, argumentet në lidhje me këtë duhet të paraqiten në kontekstin e rishikimeve periodike të mbajtjes në paraburgim që kryen Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

së materiale sipas rregullës 102(3) në çfarëdo kohe pas dhënies së njoftimit sipas rregullës 102(3), përfshirë edhe përpara afatit të përcaktuar në këtë vendim.

b. Mocionet paraprake

15. Më 19 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake u shpreh se vendimet për mocionet paraprake do të jepen të premtën, 16 korrik 2021.²³ Për arsye organizative, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ndryshon këtë afat për të enjten, 22 korrik 2021.

V. VENDIM

16. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **MIRATON** kërkesën;
- b) **ZGJAT** afatin e ZPS-së për parashtrimin e njoftimit sipas rregullës 102(3) deri të **premtën, 30 korrik 2021**;
- c) **ZGJAT** afatin e Mbrojtjes për të kërkuar materiale sipas rregullës 102(3) deri të **premtën, 24 shtator 2021**;
- d) **URDHËRON** ZPS-në që deri të **premtën, 15 tetor 2021**, ose brenda tri javësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes, cilado të jetë data më e hershme: (i) të nxjerrë ose t'i japë Mbrojtjes qasje në materialin e përzgjedhur i cili nuk ka nevojë të redaktohet; dhe (ii) të dorëzojë kërkesë për masa mbrojtëse, nëse ka, në lidhje me materialet e kërkuara

²³ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 19 maj 2021, publik, f. 451, rreshtat 16-17.

nga Mbrojtja dhe të nxjerrë këtë material me redaktime sa më shpejt të jetë e mundur, në qoftë se kërkesa miratohet;

- e) **URDHËRON** ZPS-në t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake **brenda dhjetë ditësh nga njoftimi/njoftimet e Mbrojtjes**, nëse do të ketë ndonjë mospajtim në lidhje me rëndësinë materiale të provave; dhe
- f) **INFORMON** palët dhe pjesëmarrësit që vendimet për mocionet paraprake do të nxirren **të enjten, 22 korrik 2021**.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatësi Nikola Giju
Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 24 qershor 2021

Në Hagë, Holandë